

Nr. Prot. 6475



Sekretari: Përgjegjës
Vijdhur sipas ligj
Këshillit Bashkiak
Përfundim 13.11.2025

REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
PREFEKTI I QARKUT KORÇË

Nr. 1021 Prot.

Korçë, më 12.11.2025

Lënda: Mbi bazueshmërinë ligjore të akteve të Këshillit

✓ **KËSHILLIT TË BASHKISË KOLONJË
KRYETARIT TË BASHKISË KOLONJË**

Mbështetur në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, pas verifikimit të vendimeve nr. 129 dhe nr. 130, datë 29.10.2025 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, **konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tyre**, bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nenet 54 dhe 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjin nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, udhëzimin plotësues nr. 2, datë 25.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 483, datë 02.09.2025 "Për dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025".

Në lidhje me vendimin nr. 122, datë 29.10.2025, i Këshillit të Bashkisë Kolonjë, i përcjellë me shkresën nr. 6139/1 prot., datë 05.11.2025, të Sekretarit të Këshillit, me për objekt "Për miratimin e dhënies shoqërisë "Fortis Energy and Construction" sh.p.k. të së drejtës së kalimit dhe ndërtimit të korridorit të linjës elektrike me vendodhje në Bashkinë Kolonjë, në pronësi të Bashkisë Kolonjë".

Ky vendim nuk përbën akt me karakter normativ dhe, për rrjedhojë, nuk i nënshtrohet verifikimit të ligjshmërisë nga institucioni i Prefektit, në kuptim të nenit 3, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nenit 8, shkronja "a", dhe nenit 16, pika 2, shkronja "a", të ligjit nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, si dhe nenit 13, pika 2, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, pasi:

- i drejtohet një subjekti të përcaktuar në mënyrë individuale;
- krijon një marrëdhënie juridike konkrete, të lidhur me një rast të veçantë;
- ka efekt të njëhershëm dhe jo të vazhdueshëm në kohë, si dhe nuk ka karakter të përgjithshëm.

Shënim: Në vazhdimësi kërkojmë nga strukturat përgjegjëse në bashki, konkretisht nga sektori i financës dhe sektori juridik që për propozimin e projekt akteve të përditësojnë ndryshimet e fundit ligjore. Gjithashtu bazuar në nenin 7 pika 2 e ligjit nr. 36/2024 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", sjellim në vëmendjen tuaj se dispozita e mësipërme përcakton në mënyrë të qartë se "Aktet me karakter normativ shoqërohen me një relacion përmbledhës të arsyeve për nxjerrjen e tyre, duke argumentuar për problematikat, qëllimet, objektivat që synohen të arrihen, përparësitë, si dhe efektet e pritshme nga miratimi". Lidhur me vendimet nr. 125 dhe nr. 126, datë 29.10.2025 të Këshillit të Bashkisë Kolonjë, institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë do të shprehet brenda afateve kohore të përcaktuara në ligj.

